



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:275922
Datë: 26.11.2024
Numri i dokumentit: 06506246

C-III-24-0137

Paditësi

V S P fshati B e E

Përfaqësuar nga av. F Sh, Prishtinë .

Kundër

E paditura

- Agjencia Kosovare e Privatizimit, për NSH “Liria”Bardhosh (në likuidim) Rr.“Dritan Hoxha”, Nr.55, Lakrishtë Prishtinë.”
- M V B e P
- M V2 B e P
- M M nga Kraveva Republika e Sërbisë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Diellza Hoxha gjyqtare kryesuese, Gazmend Sylaj dhe Hajrie Shala gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 nëntor 2024 merr këtë:

AKTVENDIM

- Refuzohet kërkesa e paditësit për lëshimin e masës se sigurisë .
- Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 04 tetor 2024 paditësi ka parashtruar padi pranë DHPGJS së bashku me propozimin për caktimin e masës se sigurimit (MS).

Paditësi kërkon vërtetimin e drejtës së pronësisë dhe dorëzimin e paluajtshmerisë pjesës së ngastrës kadastrale nr..ne sipërfaqe prej 2.34.84 ha ne vendin e quajtur “B ” e evidentuar ne fletën poseduese nr.. Zona Kadastrale Nëntë J (prona kontestuese).

Paditësi pretendon të drejtën e tij pronësore në pjesën e ngastrës kontestuese në bazë të blerjes nga të paditurit M V1, M V2 dhe M M dhe thekson se qysh nga viti 1996 është në posedim të përhershëm dhe të qetë të kësaj paluajtshmerie .

Paditësi thekson se këtyre të paditurve me Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komonale në Prishtinë Cnr.576/94 të datës 20.11.1995 i ishte vërtetuar e drejta e pronësisë dhe i ishte dorëzuar në pronësi një pjesë e ngastrës kadastrale nr. në sipërfaqe prej 2.34.84 ha e cila evidentohet në emër Kooperativës bujqësore “Devet Jugoviq” –Devet Jugoviq. Paditurit M, M dhe M pasi që aktgjykimi ka marr formën e prerë i janë drejtuar Shërbimit për Kadastër të Prishtinës për zbatimin e tij. Ky organ ka marr vendim nr.952-3/95-1395 të datës 07.04.1997 ku ngastra . është ndarë në tri ngastra të reja secila me sipërfaqe prej 78 ari e 28 m2 për tre bashkëpronarët por atyre kadastru u kishte dorëzuar një skicë të ndarjes së parcelës kadastrale nr.. ZK Devet Jugoviq e cila kishte sipërfaqe të përgjithshme prej 04.69.69 ha. Pas kësaj të paditurit kane shitur këtë prone paditësit V P i cili e posedon dhe shfrytëzon në mënyrë të pandërprerë i papenguar nga askush ndërsa prona kontestuese në regjistrat kadastral ende evidentohet në emër të Koperativa Bujqesore Nentej Jugoviq -NSH “Liria” Bardhosh.

Në vitin 2008 të paditurit së bashku me paditësin kane autorizuar avokatin që të dorëzoj Zyrës së Kadastrit dokumentacionin për zbatimin të aktgjykimit të plotfuqishëm i cili nga paraqitja e kërkesës të datës 15.02.2008 e deri në ditët e sotme nuk është zbatuar në Kadastër. Paditësi thekson së në bazë të shfrytëzimit të ligjshëm dhe me mirëbesim është bërë pronar i kësaj sipërfaqe të tokës në baze të nenit 40 par.1 të ligjit nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat sendore pasi këtë prone e posedon me mirëbesim që 28 vjet pa ndërprerë dhe i papenguar nga askush. Andaj nga gjykata kërkon që të vërtetohet se në bazë të blerjes nga të paditurit është pronar i një pjese të ngastrës kadastrale .. ne sipërfaqe prej 2.34.84 ha, këtë të drejt ta pranojë e paditura AKP dhe të lejoj regjistrimin e pronës kontestuese në emër të tij .

Propozimi për caktim të masës së sigurimit

Pasi që kjo njësi kadastrale evidentohet ende në emër të NSH “Liria” Bardhosh përkundër faktit se për një sipërfaqe të kësaj ngastrë ekziston aktgjykimi i formës së prerë i vitit 1995 sipas të cilit pronësia e kësaj toke ka kaluar në persona fizike ka gjasa që edhe kjo ngastrë të nënshtrohet procesit të privatizimit dhe me shitjen e të njëjtës paditësit do të shkaktohet dëm i pariparueshëm andaj propozon caktimin e MS dhe kërkon që të ndalohet të paditurës AKP- së –shitja tjetërsimi i pronës kontestuese gjer në përfundimin e procedurës gjyqësore.

Padisë ka bashkangjitur:

- Kopja e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komonale në Prishtinë nr. Cnr.576/94 të datës 20.11.1995.(tani e tutje AKTGJYKIMI).
- Kopja e aktvendimit nr.952-3/95-1395 i datës 07.04.1997 i lëshuar nga Shërbimit Kadastral i Komunës së Prishtinës.
- Kopjen e skicës së ngastrës .. e ndarë në dy pjese sip.4.69.69 ha
- Kopje e autorizimit dhënë avokatit F Sh
- Kopjen e certifikatës për ngastrën .e datës 15.02.2008

- Kopjen e parashtrës drejtuar Zyrës Kadastrale në Prishtinë .
- Kopjen e përgjigjes së Gjykatë Komonale në Prishtinë lidhur me autencitetin e Aktgjykimit Cnr.576/94 te datës 03.03.1995 (i plotfuqishëm me date 20.11.1995)
- Kopjen e njoftimit drejtuar AKP-se për kryesuesin e Autoritetit te Likuidimit te datës 05.09.2013.

Me datë 28.10.2024 AKP-ja parashtroi përgjigjen e saj ndaj propozimit për Mase te Sigurimit ne te cilën ajo në tërësi e kundërshton kërkesën e paditësit duke e konsideruar si te pa pranueshme dhe te pa bazuar ne ligj. AKP-ja pohon se kërkesa nuk i plotëson kriteret ligjore, të parapara sipas nenit 61 te ligjit për DHPGJS. Andaj, AKP propozon që kërkesën për mase te sigurimit ta refuzoj si të pabazuar.

Si prove parashtroi ;

- Certifikatën e pronësisë te datës ..në të cilën shihet se ngastra kadastrale .ka sipërfaqe prej 4.69.69 ha e cila edhe tani evidentohet ne emër Kooperativa bujqësore Nëntë Jugoviq .

Arsyetimi ligjor:

Në pajtim të nenit 61.1 të Ligjit për DHPGJS mund të nxjerrë Mase te Sigurimit (MS) me kusht që parashtruesi të jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet një MS . Sipas nenit 61.1, dëmi konsiderohet si i ‘pariparueshëm’ vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Për më tepër padia do të konsiderohej si e bazuar.

Andaj pala duhet të ofrojë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të *menjëhershëm* dhe të *pariparueshëm financiarisht* nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kriterë janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet. Barra e provave bien mbi paditësin

Pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur mbi padinë, gjykata konstaton se në këtë rast, paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonte lëshimin MS. Paditësi nuk ka parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rrezikut të dëmit dhe për më tepër të parashtrrojë asnjë dëshmi e që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm dhe i riparueshëm do të shkaktohej në qoftë se MS nuk do të lëshohej.

Për më tepër gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dokumentacionit te dorëzuar nga paditësi si dhe certifikatës se dorëzuar nga e paditura AKP konstaton se ngastrat kadastrale nuk është ndare dhe nuk ka kaluar në pronësi të paditurve M M dhe M të cilët kanë shitur pronën kontestuese paditësit V P .

Po ashtu nga Çertifikata e pronësisë e datës .. e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës se Prishtinës ngastra kadastrale nr.ka sipërfaqen e tërësishme prej 4.69.69 ha dhe është pronë shoqërore e evidentuar në emër te Kooperativës Bujqësore- Nëntë Jugoviq .

Kolegji konstaton se në këtë rast, paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonte lëshimin MS . Paditësi nuk ka parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rrezikut të dëmit dhe për më tepër të parashtrorë asnjë dëshmi e që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm dhe i riparueshëm do të shkactohej në qoftë se MS nuk do të lëshohej.

Andaj, kërkesa për lëshimin e MS nuk i plotëson kriteret ligjore ashtu siç parashihen sipas nenit 61.1 të Ligjit të DHPGJS .

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet

Paditësi ka paguar taksën gjyqësore .

Këshilla ligjore

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrorë me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Diellza Hoxha , Gjyqtare kryesuese

Gazmend Sylaj , Gjyqtar

Hajrie Shala , Gjyqtare
